REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës, më 09.06.2026

Lënda: Kthim përgjigje

,
Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:
Në lidhje me emailin tuaj dhe informacionin e kërkuar për studimin paraprak të projektit të propozuar, ju informojmë se disa nga çështjet e ngritura në kërkesën tuaj nuk janë të qarta për institucionin tonë, pasi zona e Porto Romanos dhe zona e Xhafzotajt/Rrashbullit përbëjnë territore të ndryshme dhe nuk kemi dijeni për ndonjë lidhje funksionale apo infrastrukturore ndërmjet tyre në kuptimin e referuar në kërkesë.

Gjithashtu, për sa i përket projekteve ekzistuese ose të planifikuara nga institucione të tjera publike që mund të lidhen me infrastrukturën ujore në këto zona, nuk disponojmë informacion apo të dhëna mbi projekte të tilla.

Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve ujore, furnizimin me ujë për qëllime industriale, si dhe çdo aspekt tjetër që lidhet me administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore, ju sugjerojmë t'i drejtoheni pranë Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, institucion kompetent për këtë fushë. Ky institucion do të jetë në gjendje t'ju ofrojë informacionin dhe sqarimet e nevojshme në lidhje me procedurat, kufizimet, mundësitë dhe çdo aspekt tjetër teknik apo ligjor që lidhet me përdorimin e burimeve ujore.
Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm brenda kompetencave tona.
Faleminderit